

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE DATA 30 MARS 2023

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, në mënyrë normale, do të ishte diskutimi më i gjatë dhe më intensiv në lidhje me këtë çështje. Besoj se ky është raportimi më i vakët që ka ndodhur ndonjëherë. Nuk do të qëndroj fare te raportimet e institucionit përkatës, sepse praktikisht ndikimi i tij në lidhje me një problematikë kaq të madhe, siç është uji, ndryshe nga misioni dhe detyrat që ka, është thuajse i papërfillshëm. Më mirë të qëndrojmë tek ato deklarime që marrin përsipër qeveria dhe pushteti lokal. Për sa i takon problematikës së ujit, Kryeministri i Shqipërisë në fushatën e vitit 2021 premtoi sërish 24 orë ujë. Është mirë që kjo foltore të përdoret vetëm për të thënë të vërteta. Unë i qëndroj të njëjtit angazhim që t'u referohem vetëm atyre që thonë ata vetë, sepse, për fat të keq, nuk mbajnë mend as se çfarë thonë. Ky premtoi 24 orë ujë, ndërsa në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë, e miratuar nga kjo qeveri (këtu besoj se nuk do të keni replika, sepse nuk do t'i replikoni dot dokumentet e njëri-tjetrit), jo vetëm që nuk është një objektiv i tillë, por nga objektivi i vendosur në strategjinë e mëparshme për të pasur 21 orë ujë të pijshëm, ky objektiv është ulur në 16 orë ujë. Kështu që nevojitet një koordinim në lidhje edhe me gënjeshtrat që thoni këtu. Po flas gjithmonë me dokumentet tuaja, jo tonat. Sa u takon dokumenteve politike, një pjesë e mirë e deputetëve jetojnë në Tiranë, edhe ata që vijnë nga rrethet për shkak të detyrave që kanë, kështu që duhet ta dinë se në këtë qytet çmimi është rritur mbi 40 për qind. Ky është fakt, nuk e lëviz topi. Besoj se nuk mund ta mohoni dot, sepse, po e mohuat edhe këtë, jemi në kufijtë e çmendurisë. Çmimi u rrit me angazhimin se do të ketë ujë 24 orë dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës ka thënë: "Do të kemi ujë të Korçës me çmimin e Bathores". Këto nuk janë deklaratat e mia, janë tuajat. Cila është përgjigjja sot? Të gjitha tarracat e Tiranës i kemi të mbushura me depozita uji, as që bëhet fjalë për 24 orë ujë, megjithëse ishte parashikuar brenda 5 vjetëve, por kemi hyrë në vitin e gjashtë dhe as që bëhet fjalë për këtë gjë. Me demokracinë edhe urdhra për t'i hequr depozitat, ndërkohë që depozita keni edhe në zonat në qendër të Tiranës deri te njësia 5. Jo që nuk bëhet fjalë për ujë 24 orë, por në periudha të veçanta të vitit uji shitet me bote në mes të Tiranës së Re.

Ky është realiteti. Çfarë do të themi? Do të gënjejmë tani? Vetë funksionarë të qeverisë e kanë pranuar se uji nuk mund të konsumohet. Detyrë është që konsumatorët të furnizohen me ujë higjienikisht të pastër, këtë e thotë rregullorja e ujit, e cila është miratuar, qëkur nuk mbahet mend. Ky është minimumi i standardit. Nuk mund t'u imponohemi shqiptarëve, duke u thënë se duhet ta blejnë ujin e ambalazhuar, se qeveria ka ndërmend të gënjejë. Tani është edhe kjo dëshira e madhe për t'u referuar gjithmonë kohëve më parë! Kjo është një gjë shumë e mirë dhe legjitime, nuk ka asgjë. Po sa do referoheni, se u bënë 10 vjet? Kujt do t'i referoheni? Mos u referoni më viteve 2011 dhe 2012, por mund t'i referoheni edhe vitit 1938. Ata që ishin paraardhësit tuaj deri në fund të viteve '90 i referoheshin vitit 1938, prandaj Shqipëria përfundoi me tollona dhe me gomone. Kështu që të gjitha këto janë fakte kaq të rënda, sa gjithçka që ndodh me ujin, është vetëm një spekulim i vazhdueshëm elektoral. Kushdo që në mënyrë të vërtetë jep objektiva apo jep premtime të realizueshme, quhet një njeri pamend. Nëse dikush thotë se do të ketë ujë 14 orë, sepse në zona të caktuara nuk ka ujë fare,

do të quhej budalla, sepse ne themi 24 orë, madje e themi në çdo fushatë që vjen. Këto janë faktet. Premtimi i Edi Ramës ishte mashtrim. Premtimi i Erion Veliajt ishte mashtrim. Kurdo që të shikoni premtime për ujin nga kjo qeveri, dijeni se vetëm gënjen. Falimentimi i ujësjellësve anë e mbanë vendit dhe rrëmbimi i tyre ishte një dështim i përbashkët mes qeverisë qendrore dhe asaj lokale. Po i shpërdorove dhe po i grive paratë, fondet e ujit të pijshëm, ujë nuk do të ketë dhe falimentimi do të jetë te pragu i derës.